

URDHËR
Nr. 195, datë 23.9.2024

PËR DELEGIM KOMPETENCASH

Në mbështetje të pikës 2, të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; germave “b” dhe “ç”, të nenit 13, dhe germës “a”, të nenit 21, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; si dhe germës “a”, të pikës 1, të nenit 7, dhe germës “a”, të pikës 1, të nenit 30, të rregullores “Për veprimtarinë e Kolegjit të Posaçëm të Apelit të Gjykatës Kushtetuese”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të kryetarit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit të znj. Manjola Kelolli, drejtor i Drejtorisë së Menaxhimit të Çështjeve dhe Marrëdhënieve me Median dhe Publikun, caktuar të kryejë edhe detyrat e Sekretarit të Përgjithshëm të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, me vendim të Mbledhjes së Gjyqtarëve nr. 79, datë 10.9.2024, për të kryer procedurat dhe për të nënshkruar aktet në emër të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, për marrjen me qira të ambienteve për nevoja të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

2. Znj. Manjola Kelolli nuk mund t'i nëndelegojë këto kompetenca.

3. Delegimi i kompetencave mbaron me shfuqizimin e aktit të delegimit.

4. Për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm i Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR I KOLEGJIT TË POSAÇËM TË APELIT
Sokol Çomo